



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:115419

Datë: 22.07.2025

Numri i dokumentit: 07560004

KA.nr.277/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Gent Bekeri, në konfliktin administrativ të paditësit propozuesit “Grami” SH.P.K, me NUI 810851073, me seli në Prishtinë, Rr. “Xhorxh Bush” nr.19, përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve RPHS Law, me seli në Prishtinë, Rr. “Major Mehmet Bushi” Bregu i Diellit, kundër të paditurave 1.) Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë Rr. “Migjeni” (ish banka e Lubjanës), 2.) Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, Rr. “Bulevardi Nëna Terezë”, për shkak të anulimit OSHP-së nr. 2024/1222 dt. 02.05.2025, njoftimit numër prokurimi KEK-24-2567-1-1-1 lëshuar nga KEK dhe propozimit për caktimin e masës së sigurimit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ – Vendimit, konform Nenit 46 paragrafi 2.2.2 të LKA-së, më datë 14.07.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET e bazuar padia dhe propozimi për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të paditësit 1.) Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë 2.) Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET vendimi i kundërshtuar me numër OSHP:2024:1222 të datës 02.05.2025, si i kundërligjshëm dhe çështja i kthehet të paditurës së parë OSHP në rivendosje. OBLIGOHET OSHP që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi të merr Vendim në pajtim me dispozitat ligjore të LLPA-se dhe vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.
- III. SHTYHET ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar numër OSHP:2024:1222 të datës 02.05.2025, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

IV. Secila palë i bart veprimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me datë 05.06.2025, në Gjykatën Komerciale, Departamenti për Çështje Administrative Paditësi/Propozuesi Kompania “Grami” SH.P.K, me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të tij me autorizim ka parashtruar padi kundër të paditurave 1.) Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë 2.) Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, në çështjen e konfliktit administrativ të anulimit të vendimit me numër OSHP:2024:1222 të datës 02.05.2025, me propozim për shtyrje të ekzekutimit të këtij vendimi.

Në parashtrësën e propozimit, Paditësi ka theksuar se plotësohen kushtet për caktimin e masës së sigurimit pasi që ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit të pakthyeshem ndaj interesave të Propozuesit dhe caktimi i masës së sigurimit nuk e cenon interesin publik.

Paditësi ka theksuar se me të paditurin e dytë KEK Sh.A. ka histori të gjatë në aktivitete të prokurimit, e rrjedhimisht kësaj kishte aplikuar në tenderin sipas aktivitetit të prokurimit “*Furnizim me gëlqere të hidratizuar*” me nr. të prokurimit KEK-24-2567-1-1-1, nën kushtet dhe llojin e njëjtë të dokumentacionit të kërkuar, por që tani në këtë aktivitet është shpallur ofertues i papërgjegjshëm pa të drejtë dhe pa shqyrtim merititor të aplikacionit dhe dosjes së tenderit.

Paditësi konsideron se natyra e propozimit të tij është urgjente në vendosje pasi që i padituri i dytë e ka nënshkruar marrëveshjen me OE GEO CONEX & DINI ndërkaq nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në zbatimin e vendimit gjyqësor / Aktgjykimit KA.nr.132/25, duke shpërfillur tërësisht masën e sigurimit të vendosur me këtë Aktgjykim. Rrjedhimisht zbatimi i kontratës së kundërshtarit të dytë KEK Sh.A. me OE GEO CONEX & DINI përveç se do t’i shkaktonte dëme të mëdha Propozuesit në emër të fitimit të humbur, do të krijonte një praktikë të gabuar e cila shkakton dëme të pakthyeshme propozuesit si dhe dëme të mëdha buxhetit shtetëror për shkak të çmimit më të lartë të ofertuar nga fituesi i shpallur në raport me propozuesin e sigurimit.

Më tej Paditësi ka shtuar se me caktimin e masës së sigurimit të propozuar nuk cenohet rëndë interesi publik pasi që i padituri i dytë ndonëse e ka shpërblyer me kontratë OE GEO CONEX & DINI për furnizim me gëlqere për sasinë 1000 ton në dt. 12.07.2024, në vijim për një periudhë të shkurtër në dt. 10.07.2024 ka kontraktuar edhe operatorin tjetër Eksim com Sh.p.k. për sasinë 3.5 ton sipas aktiviteteve të prokurimit me nr.: 24-7013-1-4-7 dt. 10.07.2024, 24-7158-1-4-7 dt. 10.07.2024 dhe 24-77159-1-4-7 dt. 10.07.2024. Nga kjo rezulton se shtyrja e ekzekutimit të

Vendimit të atakuar dhe mos zbatimi i kontratës me OE GEO CONEX & DINI për aktivitetin e prokurimit “*Furnizim me gëlqere të hidratizuar*” me nr. të prokurimit KEK-24-2567-1-1-1 nuk do të rezultonte me cenim të interesit publik.

Nga sa u tha më lartë i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesa për caktimin e masës së sigurimit si në hyrje të këtij arsyetimi, ndërsa sa i përket kërkesëpadisë ka kërkuar që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të anulohet si i paligjshëm vendimi i organit shqyrtues të prokurimit.

E Paditura e parë OSHP në parashtresën e dt. 20.06.2025 e kundërshtuar në tërësi propozimi për caktimin e masës së sigurimit duke theksuar se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet ligjore për caktimin e masës, me sa vijon:

- Propozuesi nuk e ka provuar dëmin e rëndë që kanoset t’i shkaktohet pasi që ai nuk i ka plotësuar në tërësi kushtet sa i përket dokumentacionit për tu shpallur fitues i aktivitetit të prokurimit pasi që në dosjen e tij ka munguar dokumenti “b) Certifikata e kualitetit e lëshuar nga një laborator i certifikuar për prodhuesin e Ca(OH)_2 sipas standardit 459-1. Propozuesi pretendon ta ketë plotësuar këtë kusht me dorëzimin e një raporti nga laboratorit “Instituti IMS AD Beograd” por që Autoriteti Kontraktues – këtu kundërshtari i dytë sqaron se nuk është ofruar certifikatë sipas standardit të kërkuar por Raport testimi i vitit 2020. Më tej ekspertët e OSHP-së kanë vlerësuar se raporti i testimit nuk mund të quhet ekuivalent Certifikatën e kualitetit pasi që raportet e testimi bëhen vetëm në bazë të kërkesës së vetë palës e cila i përgjigjet vlerësimit të një mostre të caktuar nëse i përmbush apo jo standardet specifike. Poashtu nga hulumtimi zyrtar i kryer, është gjetur se “Instituti IMS AD Beograd” është certifikuar në vitin 2023 për të kryer certifikime për gëlqere sipas standardit EN 459-1, ndërkaq Propozuesi ka paraqitur në cilësi të dokumentit raportin e vitit 2020. Prandaj kundërshtari i parë ka ardhur në përfundim se propozuesi nuk i ka plotësuar kushtet për tu shpallur fitues i tenderit.
- Propozuesi nuk e ka dëshmuar se caktimin i masës së sigurimit nuk e cenon rëndë interesin publik pasi që është pikërisht interesi publik që atakohet me kërkesën e tij sepse kundërshtari i sigurimit në mënyrë të përgjegjshme bazuar në nenin 1 dhe 6 të Ligjit për prokurimin publik është siguruar për mënyrën e shpenzimit të fondeve publike.

Në përfundim të parashtresës, e paditura e parë ka theksuar se konform nenit 7.1 të LPK-së barra e të provuarit të fakteve me prova bie mbi paditësin / propozuesin, e që me propozimin e tij i

njëjti nuk e ka dëshmuar më asnjë prove se i ka plotësuar kushtet ligjore lidhur me caktimin e masës së sigurimit, i ka propozuar gjykatës që të hudhet poshtë propozimi i paditësit për caktimin e masës së sigurimit si i pabazuar, dhe të lejë në fuqi deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës – Vendimin e OSHP-së nr. 2024/1222.

E paditura e dytë KEK Sh.A. e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurimit, duke theksuar s'ene cilësinë e Autoritetit Kontraktues është i obliguar që të veprojë sipas vendimit përfundimtar të OSHP-së, ndërkaq duke parë natyrën e kontestit caktimi i masës së sigurimit nuk ka asnjë kuptim faktik e as juridik për caktimin e saj. Me tej KEK Sh.A. thekson se nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet për caktimin e masës së sigurimit duke i kundërshtuar të gjitha arsyetimet e propozuesit si të pabazuara, sepse vlerëson se AK ka vepruar në përputhje me Vendimin e OSHP-së, dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim / vendim jo ligjor. Më tej i mbështet të gjitha arsyetimet dhe sqarimet e OSHP-së, duke i cilësuar ato si shumë të qarta sa i përket arsyetimit të shkaqeve se pse Propozuesi Grami është eliminuar në aktivitetin publik të prokurimit si ën këtë çështje. Ka theksuar se kërkesa për caktimin e masës që kanë të bëjnë me tjetërsimin e pronës, asgjësimin apo fshehjen në kuptim të LPK-së lidhen me natyra të tjera të kontestit ndërkaq caktimi i një mase të sigurimit në këtë rast do t'i shkaktonte dëm dhe vështirësi Kundërshtarit të dytë në funksionim dhe menaxhim të ndërmarrjes si dhe do t'i shkaktonte dëme të pariparueshme.

Nga shqyrtimi paraprak i padisë gjykata konstatoj se në vendimin e dhënë në rivendosje, e nxjerrë nga e paditura Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, në pikën I e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e “Grami” SH.P.K, me nr. 2024/1222 e datës 02.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me gëlqere të hidratizuar” me numër të prokurimit KEK -24-2567-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues “Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., ndërsa në pikën II e ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues “Korporata Energjetike e Kosovës” SH.A., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me gëlqere të hidratizuar” me numër të prokurimit KEK-24-2567-1-1-1.

Gjykata vlerëson se dispozitivi i vendimit me të cilin aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e “Grami” SH.P.K, me nr. 2024/1222 e datës 02.05.2025 është në kundërshtim me arsyetimin, sepse as në dispozitiv të vendimit të kundërshtuar dhe as ne arsyetim nuk mund të konstatohet se cilat pretendime te ankesës janë aprovuar pjesërisht. Përderisa në arsyetim të vendimit përshkruhet dy pretendime te paditësit në ankesë dhe që të dy pretendimet vlerësohen si të pabazuara në anën tjetër thuhet se *Paneli Shqyrtues ka gjetur se ankesa e OE është pjesërisht e*

bazuar dhe duhet të aprovohet pjesërisht pa dhënë asnjë sqarim se cilat pretendime janë të bazuara për të cilat rrjedhimisht vendimi është aprovuar pjesërisht. Në këtë kuptim vendimi i kundërshtuar është i paqartë dhe kundërthënës, në kundërshtim me Neni 48 të Ligjit Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA-së), prandaj si i kundërligjshëm duhet të anulohet.

Neni 48 LPPA-së përcakton: 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. *Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*

Rrjedhimisht në rastin në fjalë vendimi i OSHP -së, duhet të përmbaj arsyetimin e qartë për aprovim të pjesshëm, duke përcaktuar saktësisht se cilat pretendime të paditësit janë të bazuara dhe të vlerësohet ndikimi i tyre në ligjshmërinë e procedurës së prokurimit sepse vendimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë sqarim për këtë vendim të pjesshëm, dhe i tërë arsyetimi është në kundërthënie me dispozitivin e tij.

Neni 52 përcakton se 1. *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.*

E paditura OSHP obligohet që në procedurë të rishqyrtimit të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, ashtu që secilin pretendim të OE ankues ta shqyrtoj, më saktësisht për aprovimin e pjesërisht t'i përshkruaj dhe t'i vlerësoj pretendimet e paditësit, dhe për çdo konstatim të jap arsye të qarta dhe të mjaftueshme të bazuara në prova konkrete dhe specifike, në dispozitiv të përcaktoj saktë se cila pjesë e ankesës është aprovuar, dhe cila pjesë është refuzuar.

Prandaj për arsye se vendimi i kundërshtuar u konstatua i kundërligjshëm, bazuar në nenin 100 par. 1 të LKA-së, për caktimin e masës së sigurisë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) *marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës; b) marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik*, Gjykata vlerëson se në zbatimin duhet të pezullohet deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, sepse diskrecioni i organit administrativ i ushtruar në mënyrë të kundërligjshme pa arsyetime dhe prova të bazuara është në dëm të interesit publik për të garantuar përdorimin e mjeteve efektive ligjore dhe zbatimin e procedurave të prokurimit sipas dispozitave ligjore të LPP-së të detyrueshme për AK dhe OSHP-ne.

Bazuar në Nenin 60 dhe 65 të LKA-se, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata refuzoj kërkesën për shpenzimet procedurale si e pabazuar në prova.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.277/25 datë 14.07.2025

Gjyqtari

Gent Beker

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.